



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.942/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Afijete Sada-Glllogjani kryesuese dhe Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Afrim Namani nga Komuna e Vushtrris, antar i kryesis nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrris, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.942/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Afrim Namani nga Komuna e Vushtrris, antar i kryesis nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në komunën e Vushtrris, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në 11 Vendvotimet në Komunën e Vushtrrisë.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.942/2021 të paraqitur nga Afrim Namani nga Komuna e Vushtrris, antar i kryesis nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në komunën e Vushtrris, me të cilën pretendon se ka pasur mos përputhje në mes të rezultati preliminar i shpallur nga KQZ-ja dhe atyre të KVV-së në Komunën e Vushtrrisë dhe se kërkon nga PZAP, që ta urdhëroj KQZ-në ti ri-numëroj 11 Vendvotime në Komunën e Vushtrrisë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Afrim Namani nga Komuna e Vushtrrisë, anëtar i kryesisë nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në komunën e Vushtrris, me të cilën kërkon rinumërim të votave në 11 vendvotimin në Komunën e Vushtrrisë, është i pa bazuar. Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tijë, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi

ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.942/2021 më datën 06.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Glligjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.